

MIRATOHET

KRYETARE

**Lindita NIKOLLA**

## **REZOLUTË**

### **PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE PËR GJENDJEN NË SHËRBIMIN CIVIL PËR VITIN 2023**

#### **Kuvendi i Shqipërisë,**

Duke vlerësuar rolin e Departamentit të Administratës Publike si njësi përgjegjëse në kuptim të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave shtetërore në shërbimin civil, mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore;

Duke mbështetur DAP-in për zhvillimin e mëtejshëm të një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të paanshëm, të pavarur dhe të bazuar në meritë;

Duke konsideruar përparësinë e zhvillimit të mëtejshëm të reformës së administratës publike si një prioritet kyç për hapjen e negociatave të pranimit në Bashkimin Evropian;

#### **Vlerëson veprimtarinë e Departamentit të Administratës Publike për vitin 2023 në drejtim të:**

Masave të marra lidhur me Strategjinë Ndërsektoriale të Reformës së Administratës Publike (SNRAP).

Bashkërendimin e punës nga ana e negociatorit përgjegjës për RAP-in me institucionet përgjegjëse për hartimin e udhërrëfyesit për periudhën kohore 2023 – 2030.

Përcaktimit të masave prioritare të organizuara në 5 shtylla, bazuar në parimet e Bashkimit Evropian për administratën publike.

Miratimit të VKM-së nr. 737, datë 13.12.2023, “Për miratimin e Udhërrëfyesit për Reformën në Administratën Publike 2023 – 2030”.

Realizimit të planit të rekrutimit në masën 72%.

Uljes së rasteve për vitin 2023 në krahasim me vitin 2022 në vlerën 15% të lirimeve me dorëheqje; 5% lirime për arsye të plotësimit të moshës së pensionit; rritje me 42.1% të lirimeve

për shkak të masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”; ulje me 50% të lirimeve për shkak të ristrukturimit.

Administrimit gjatë vitit 2023 të 2000 formularëve të vetëdeklarimit të plotësuar nga subjektet vetëdeklaruese në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar.

Miratimit të ligjit nr. 34/2023 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, i ndryshuar, nëpërmjet të cilit u realizua: (i) përcaktimi i raporteve të drejta të pagës së titullarëve të institucioneve të pavarura dhe funksionarëve politikë me pagën e Presidentit; (ii) rritja e pagës për titullarët e institucioneve kushtetuese e të pavarura dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj në masën 35 – 95%.

Miratimit të ligjit nr. 35/2023, që përcakton kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe për pagën bazë minimale në shkallë vendi.

Zhvillimit të kapaciteteve të administratës publike përmes trajnimit pranë ASPA-s.

### **Kuvendi kërkon që Departamenti i Administratës Publike për vitin 2024 të angazhohet në këto drejtime:**

1. Të asistojë dhe udhëzojë institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil, në përgatitjen e planit të nevojave për rekrutim në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 108, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.

2. Të miratojë brenda vitit 2024 Strategjinë e re Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2023-2030, si dhe të fillojë zbatimin e saj.

3. Të rishikojë efektivitetin e strukturave ekzistuese të monitorimit.

4. Të angazhohet konkretisht gjatë vitit 2024 për automatizimin e sistemit të listëpagesave nëpërmjet Sistemit Informatik për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) në të gjithë sektorin publik.

5. Të angazhohet në hartimin e ndryshimeve të nevojshme ligjore në ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, me qëllim përmirësimin e procesit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, strukturën e pagës, procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, lirimit, transferimit, pezullimit, etj.

6. Të angazhohet në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) në fuqizimin e kapaciteteve të nëpunësve të administratës publike në drejtim të: politikëbërjes dhe hartimit të legjislacionit; përafrimit të legjislacionit dhe procesit të integritetit; njohurive fillestare të nevojshme për nëpunësit e rinj civilë; zhvillimin e karrierës së nëpunësve civilë; njohurive specifike manaxheriale dhe të tjera për nivelin drejtues.

Miratuar në datën 26.7.2024